

**VENDIM**  
**Nr. 320, datë 31.5.2018**

**PËR PËRDORIMIN E FONDEVE BUXHETORE TË VITIT 2018 PËR FINANCIMIN  
E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE PËR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE  
QË RRJEDHIN NGA KONTRATA KONCESIONARE NR. 6021 REP.,  
NR. 2894 KOL., DATË 31.8.2017, “PËR NDËRTIM *LANDFILL*-i, INCENERATORI  
DHE REHABILITIM  
I VENDDEPOZITIMEVE EKZISTUESE NË TIRANË DHE PRODHIMIN E  
ENERGJISË ELEKTRIKE, ZONA E TRAJTIMIT TË MBETJEVE TIRANË (ZTMT)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 107/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondeve buxhetore të vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ekonomisë, në programin e menaxhimit të mbetjeve urbane, për financimin e njërive të qeverisjes vendore të Qarkut Tiranë/Bashkia Tiranë, për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata koncesionare nr. 6021 rep., nr. 2894 kol., datë 31.8.2017, “Për ndërtim *landfill*-i, inceneratori dhe rehabilitim i venddepozitimeve ekzistuese në Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike, zona e trajtimit të mbetjeve Tiranë (ZTMT)”.

2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në rolin e autoritetit kontraktues, dhe njësitë e qeverisjes vendore të qarkut Tiranë/Bashkia Tiranë, për përdorimin e financimit në përmbushje të detyrimeve kontraktore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të bashkërendojnë për kryerjen e pagesave ndaj koncesionarit, sipas skeduleve të pagesave që rrjedhin nga kontrata koncesionare.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe njësitë e qeverisjes vendore të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**